

VENDIM
Nr.5, datë 22.1.2007

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbëra nga:

Kristaq Ngjela	Kryesues
Spiro Spiro	Anëtar
Perikli Zaharia	Anëtar
Besnik Imeraj	Anëtar
Fatos Lulo	Anëtar
Artan Hoxha	Anëtar
Ardian Dvorani	Anëtar
Shpresa Beçaj	Anëtare
Gani Dizdari	Anëtar
Evjeni Sinoimeri	Anëtare
Agron Lamaj	Anëtar
Ylvi Myrtja	Anëtar
Irma Bala	Anëtare

në seancën gjyqësore të datës 22.1.2007, shqyrtuan çështjen civile, që i përket:

PADITËS: BESNIK KAÇURRI, përfaqësuar nga av. Vitore Tusha.

I PADITUR: GJYKATA E LARTË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, në mungesë.

OBJEKTI I PADISË: Shpërblim i dëmit të ardhur nga largimi nga detyra pa arsye të përligjura.

BAZA LIGJORE: Neni 20 i ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë”

Neni 143, 144, 145, 153, 154, 154/a të Kodit të Punës.

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr.6005, datë 7.12.2004, ka vendosur:

“Pranimin e padisë së paditësit Besnik Kaçurri.

Detyrimin e palës së paditur, Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë, të dëmshpërblejë paditësin Besnik Kaçurri me pagën e një viti punës.”

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.457, datë 7.4.2005, ka vendosur:

“Ndryshimin e vendimit nr.6005, datë 7.2.2004 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë si vijon:

Detyrimin e palës së paditur, Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë, t’i paguajë paditësit Besnik Kaçurri pagën e 5 muajve dëmshpërblim për zgjidhje të menjëhershme e të pajustifikuar të kontratës së punës.

T’i paguhet 3 muaj pagë për mosrespektim të procedurës për afatin e njoftimit.

T’i paguhet dhe tetë pesëmbëdhjetëditësha pagë, si shpërblim për vjetërsi në punë.”

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit dhe vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, brenda afatit ligjor, në mbështetje të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, ka paraqitur rekurs pala e paditur, Gjykata e Lartë, e cila kërkon ndryshimin e vendimeve dhe rrëzimin e padisë, duke parashtruar këto shkaqe:

- Gjykata ka lejuar shkelje të rëndë të normave procedurale. Në gjykimin, në Gjykatën e Apelit, ka marrë pjesë gjyqtari Metush Saraçi, ish-anëtar i Gjykatës së Lartë. Është fakt i njohur që paditësi për një periudhë kohe ka qenë ndihmës ligjor i gjyqtarit Metush Saraçi. Në këto kushte gjyqtari Saraçi kishte ndalim ligjor të merrte pjesë në gjykimin e kësaj çështjeje, pasi ai ka qenë punëdhënës i paditësit (neni 72, pikat 5, 6 të Kodit të Procedurës Civile), në bazë të nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile ai duhej të vlerësonte dhe të hiqte dorë nga gjykimi i kësaj çështjeje.

- Nuk është respektuar ligji, gjykatat kanë dhënë një vendim haptazi të kundërligjshëm. Gjykatat nuk kanë përcaktuar drejt marrëdhënien juridike, midis palëve mbi të cilën ka lindur konflikti. Gjykatat gabimisht i referohen dhe interpretojnë dispozitat e Kodit të Punës dhe të ligjit për

Shërbimin Civil. Ndhmësit ligjorë kanë status të veçantë, bazuar në ligj të veçantë, duke lidhur një kontratë të veçantë shërbimi publik, afati i së cilës nuk mund të jetë më i gjatë se vetë mandati i gjyqtarit përkatës. Gjykata i është shmangur interpretimit të nenit 20 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000.

- Neni 20 i ligjit bën një rregullim të plotë të një kontrate specifike të punësimit të një funksionari publik, siç është ndihmësi ligjor i Gjykatës së Lartë, duke i dhënë atij një status të përcaktuar qartë. As kjo dispozitë e as ndonjë tjetër nuk të referon në Kodin e Punës.

Në mbështetje të nenit 477 të Kodit të Procedurës Civile, brenda afatit ligjor ka paraqitur kundërrekurs pala paditëse, Besnik Kaçurri, duke kërkuar mospranimin e rekursit për këto shkaqe:

- Argumentet ligjore të paraqitura në rekurs janë paraqitur dhe në ankimin në apel, duke u analizuar nga gjykata si të pabazuara.

- Qoftë në padi, dhe në vendimet e gjykatave është përcaktuar saktë marrëdhënia juridike për të cilën ka lindur mosmarrëveshja dhe është pikërisht marrëdhëniet e punës së paditësit si punëmarrës dhe institucionit, Gjykata e Lartë, përfaqësuar nga kryetari i saj, me cilësinë e punëmarrësit. Paditësi ka pretenduar dhe gjykatat kanë pranuar se këto marrëdhënie nuk rregullohen nga një ligj i vetëm.

- Përsa i përket shkeljes procedurale të pretenduar, nuk është i vërtetë fakti që unë kam qenë ndihmës ligjor i gjyqtarit Metush Saraçi.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi, datë 25.11.2005, ka vendosur:

“Kalimin për gjykim të rekursit të paraqitur nga Gjykata e Lartë.”

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.2049 regj. them., datë 6.6.2006, ka vendosur:

“Kalimin e çështjes, me palë Besnik Kaçurri-paditës, dhe Gjykata e Lartë-e paditur, për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë”.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka konstatuar se në një çështje analoge, ku Gjykata e Kasacionit (sot Gjykata e Lartë) e Shqipërisë ka qenë e paditur nga ish-kryesekretari i saj, plenumi i kësaj gjykate ka arsyetuar nëpërmjet vendimit nr.3454, datë 30.9.1994, si më poshtë: *“Për të siguruar një gjykim të paanshëm Gjykata e Kasacionit nuk mund të bëjë vlerësim të ri të rrethanave që ka pranuar Gjykata e Apelit” dhe se “ndodhemi përpara një rasti të veçantë, ku kjo Gjykatë, për të mos cenuar paanësinë e saj, duhet t’i bindet vendimit të gjykatës së paanshme, asaj të apelit, pavarësisht se kjo është një hallkë më e ulët”.*

Në zbatim të nenit 17 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”*, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka konkluduar se: *“Nuk mund ta shqyrtojë këtë çështje, për arsye se: Në respektim të një gjykimi të drejtë, siç parashikohet nga neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), për të siguruar paanshmërinë në gjykimin e kësaj çështjeje dhe në ballafaqim me praktikën e mësipërme të plenumit të Gjykatës së Kasacionit (sot Gjykata e Lartë), del e nevojshme që çështja t’i kalojë për gjykim Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Me këtë rast Kolegjeve të Bashkuara u jepet mundësia të njësojnë ose të ndryshojnë praktikën gjyqësore në frymën e KEDNJ.”*

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatorët e çështjes, gjyqtarët Fatos Lulo dhe Agron Lamaj, përfaqësuesen e palës paditëse, që kërkoj mosshqyrtimin e çështjes nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mungesë të palës së paditur, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

VËREJNË:

Vendimi nr.457, datë 7.4.2005 i Gjykatës së Apelit Tiranë dhe vendimi nr.6005, datë 7.12.2004 i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë duhen ndryshuar, duke u rrëzuar padia e paditësit Besnik Kaçurri.

Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore rezulton se paditësi Besnik Kaçurri ka filluar punë pranë palës së paditur me cilësinë e këshilltarit juridik, në bazë të urdhrit nr.6, datë 1.9.1996 të Kryetarit të Gjykatës së Kasacionit. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.8588, datë 15.5.2000 *“Për*

organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë”, paditësi ka vazhduar marrëdhëniet e punës me cilësinë e ndihmësit ligjor. Megjithëse në dosjen gjyqësore nuk figuron të jetë administruar akti formal, është konstatuar, e pranuar edhe nga palët, se paditësi e ka kryer këtë detyrë pranë gjyqtarit Bashkim Caka, deri në përfundimin e mandatit të këtij të fundit. Nuk provohet, gjithashtu, që paditësi të ketë punuar ndonjë periudhë kohe si ndihmës ligjor i gjyqtarit Metush Saraçi, në atë kohë gjyqtar i Gjykatës së Lartë, aktualisht gjyqtar që ka gjykuar çështjen në fjalë në Gjykatën e Apelit. Për rrjedhojë, ndryshe nga sa pretendohet në rekurs, gjyqtari Saraçi nuk kishte pengesë ligjore për gjykimin e kësaj çështjeje në apel.

Me urdhrin nr.152, datë 1.9.2004 të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, është urdhëruar ndërprerja e marrëdhënieve financiare për paditësin, me arsyetimin se gjyqtarit Bashkim Caka i ka mbaruar mandati i detyrës së gjyqtarit e për rrjedhojë edhe ndihmësi i tij ligjor nuk duhet të vazhdojë marrëdhëniet e punës pranë Gjykatës së Lartë.

Paditësi ka pretenduar se është larguar nga detyra padrejtësisht. Në bazë të pretendimeve të parashtruara në kërkesëpadi, paditësi ka vlerësuar se, meqë në ligjin organik të Gjykatës së Lartë nuk janë parashikuar dispozitat të posaçme për procedurat e largimit nga detyra të ndihmësit ligjor, duhet të ishin zbatuar për analogji dispozitat e Kodit të Punës. Paditësi e ka konsideruar largimin e tij nga detyra si zgjidhje të menjëhershme të marrëdhënieve të punës pa shkaqe të arsyeshme. Sipas paditësit, meqë ligji hesht lidhur me afatin e kësaj kontrate të punës, duke iu referuar tërthorazi parimeve të përgjithshme të parashikuara në nenin 140 të Kodit të Punës, konsiderohet “me kohëzgjatje të pacaktuar” çdo kontratë, e cila nuk ka të përcaktuar një afat të caktuar.

Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr.6005, datë 7.12.2004 ka pranuar padinë e paditësit, duke vendosur detyrimin e palës së paditur të dëmshpërblejë paditësin me pagën e një viti pune. Gjykata e Shkallës së Parë ka arsyetuar se vetë fakti që neni 20/5 i ligjit organik nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë” parashikon largimin nga detyra pa shkaqe të përligjura, pa përcaktuar se në cilat raste do të konsideroheshin këto shkaqe të përligjura, të çon në përfundimin se në këtë trajtim dispozitat kryesore do të jenë ato të parashikuara në Kodin e Punës. Sipas Gjykatës së Shkallës së Parë, nga faktet dhe provat e paraqitura, ka rezultuar se nga ana e punëdhënësit (Kryetari i Gjykatës së Lartë, neni 7/ç i ligjit nr.8588, datë 15.3.2000) nuk është respektuar procedura e njoftimit, parashikuar nga neni 143, 144 i Kodit të Punës, por zgjidhja e kontratës është bërë e menjëhershme. Duke analizuar motivacionin e kësaj ndërprerjeje (për shkak të mbarimit të mandatit të gjyqtarit Bashkim Caka), Gjykata e Shkallës së Parë ka konkluduar se ai nuk përbën shkak të justifikuar të parashikuar nga neni 153, 154 i Kodit të Punës. Gjykata ka konstatuar se ky motivacion nuk përbën shkak të parashikuar shprehimisht as në ligjin organik, neni 20, duke e trajtuar rastin konkret si zgjidhje të menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës nga punëdhënësi, parashikuar nga neni 155 i Kodit të Punës.

Gjykata e Apelit ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, duke arsyetuar se megjithëse kjo gjykatë citon dispozitat e Kodit të Punës, ka vendosur të pranojë padinë duke u bazuar në nenin 20 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, pa u shprehur për kërkimet e tjera që përmban kërkesëpadia, si dëmshpërblimi për moszbatimin e procedurave të njoftimit, vjetërsinë në punë, largimin pa shkaqe të përligjura. Gjykata e Apelit argumenton në vendimin e saj se duhet të përcaktohet natyra e marrëdhënies juridike, natyra e konfliktit, mënyra e zgjidhjes dhe baza ligjore përkatëse. Sipas Gjykatës së Apelit, për një përcaktim të drejtë të marrëdhënies juridike dhe të pozicionit juridik të ndërgjyqësve në marrëdhënien e krijuar, në rastin konkret duhet të merret si referencë ligji nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”, dispozitat e Kodit të Punës dhe ato të parashikuara në ligjin për statusin e nëpunësit civil, si dhe praktika gjyqësore, vendimet e Kolegjeve të Bashkuara, si dhe zgjidhjet e dhëna nga kolegjet civile të Gjykatës së Lartë për raste analoge. Gjykata e Apelit ka vlerësuar se në rastin në gjykim ndodhemi para një marrëdhënieje juridike të punësimit, e cila gjen mbështetje ligjore dhe duhet të trajtohet në bazë të Kodit të Punës. Gjykata e Apelit ka konkluduar se paditësi gëzon mbrojtje ligjore vetëm për të drejtat që burojnë nga nenet 143, 145/1 dhe 155 të Kodit të Punës, shpërblimin për mosrespektim të procedurës për afatin e njoftimit, të pagës për vjetërsi shërbimi dhe për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës, pasi punëdhënësi ka përjashtuar mundësinë e shqyrtimit në themel të substancës së çështjes, d.m.th. nëse ekziston një shkak i përligjur i arsyeshëm për zgjidhjen e kontratës së punës.

Konstatohet se çështja nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka kaluar për gjykim në Kolegjet e Bashkuara, në zbatim të nenit 141/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 17 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”. Në arsyetimin që i ka bërë Kolegji Civil vendimit për kalimin e çështjes për gjykim në Kolegjet e Bashkuara, argumentohet nevoja e njësimi të praktikës në lidhje me respektimin e parimit të gjykimit të çështjes nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme.

Në këtë përfundim është arritur, pasi gjatë gjykimit të çështjes nga ana e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, paditësi ka paraqitur paraprakisht pretendimin se çështja konkrete nuk duhet të shqyrtohet nga kjo gjykatë. Këtë kërkesë paraprake, pala paditëse e mbështet në arsyetimin se Gjykata e Lartë nuk mund të jetë e paanshme në gjykimin e kërtimeve të tij, për shkak se në këtë gjykim ky institucion është në pozitën e të paditurit.

Sipas palës paditëse, shqyrtimi i kësaj çështjeje nga ana e Gjykatës së Lartë, do të cenonte parimin e paanshmërisë, si element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor të parashikuar në Konventën Europiane të Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Kushtetutën e Shqipërisë, Kodin e Procedurës Civile, si dhe në praktikën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë.

Për të argumentuar këtë pretendim, pala paditëse ka paraqitur një vendim të Gjykatës së Kasacionit (sot Gjykata e Lartë) të Republikës së Shqipërisë. Me vendimin nr.3454, datë 30.9.1994 të plenumit të Gjykatës së Kasacionit është vendosur: “Lënia në fuqi e vendimit nr.1698, datë 29.7.1994 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit”.

Ky vendim i plenumit të Gjykatës së Kasacionit është marrë gjatë shqyrtimit të çështjes civile me palë paditëse-Ylli Mahmuda (ish-kryesekretar i gjykatës), palë të paditur-Gjykata e Kasacionit dhe objekt padie-rimarrje në punë. Gjatë gjykimit të kësaj çështjeje, *Gjykata e Rrethit Tiranë* me vendimin nr.5046, datë 23.12.1993 ka vendosur: “Rrëzimin e padisë”. *Gjykata e Apelit Tiranë*, me vendimin nr.294, datë 29.3.1994, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr.5046, datë 23.12.1993 të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe duke e gjykuar çështjen në fakt - rimarrjen e paditësit në punën e mëparshme.” *Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit* me vendimin nr.1309, datë 26.5.1994 ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr.294, datë 29.3.1994 të Gjykatës së Apelit Tiranë e lënien në fuqi të vendimit nr.5046, datë 23.12.1993 të Gjykatës së Rrethit Tiranë.” *Plenumi i Gjykatës së Kasacionit* me vendimin nr.1652, datë 26.7.1994 ka vendosur: “Prishjen e vendimit nr.1309, datë 26.5.1994 të *Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit* e dërgimin e çështjes për rigjykim po në këtë kolegji me trup gjykues tjetër”. Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit me vendimin nr.29.7.1994 ka vendosur “Lënia në fuqi të vendimit nr.294, datë 29.3.1994 të Gjykatës së Apelit Tiranë”.

Kundër këtyre vendimeve ka ushtruar kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë Kryetari i Gjykatës së Kasacionit, duke kërkuar prishjen e vendimeve dhe lënien në fuqi të vendimit nr.5046, datë 23.12.1993 të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Përfundimisht *plenumi i Gjykatës së Kasacionit* ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.1698, datë 29.7.1994 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Me këtë vendim Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë kishte vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.294, datë 29.3.1994 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në këtë vendim, plenumi i Gjykatës së Kasacionit arsyeton si vijon: “Duhet të mbahet në konsideratë neni 40 i ligjit nr.7692, datë 31.3.1993 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, garancia për një gjykim të drejtë. Në këtë gjykim Gjykata e Kasacionit është vetë palë në gjykim. Në qoftë se kjo gjykatë do të prishë vendimin e Gjykatës së Apelit dhe do të zgjidhë çështjen në disfavor të paditësit, do të tregohej e njëanshme. Për të siguruar një gjykim të paanshëm Gjykata e Kasacionit nuk mund të bëjë një vlerësim të ri të rrethanave që ka pranuar Gjykata e Apelit. Ndodhemi para një rasti të veçantë ku Gjykata e Kasacionit për të mos cenuar paanësinë e saj duhet t’i bindet vendimit të gjykatës së paanshme asaj të Apelit, pavarësisht se kjo është një hallkë më e ulët.”

Pala paditëse pretendon, gjithashtu, se kërkesa për mosshqyrtimin e çështjes konkrete në Gjykatën e Lartë gjen mbështetje dhe në praktikën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe konkretisht në çështjet “Findley vs BM”, “Piersack vs Belgjikës”, “Hauschildt vs Danimarkës” dhe “Demicoli vs Maltës”, megjithëse vetëm sa i përmend këto çështje, pa bërë asnjë analizë e pa dhënë asnjë argument se ku qëndron ngjashmëria e çështjes në shqyrtim nga kjo gjykatë me çështjet e shqyrtuara nga Gjykata e Strasburgut.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vërejnë se këto çështje janë të ndryshme, prandaj vendimet e dhëna për to nuk mund të shërbejnë si precedentë (*case law*) për zgjidhjen e çështjes në fjalë.

Në rastin konkret, për të gjykuar në lidhje me respektimin e parimit të zhvillimit të gjykimin nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë u referohen dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Konventës së Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të Këshillit të Europës dhe legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Në nenin 33 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë sanksionohet se “Kushdo ka të drejtë të dëgjohet para se të gjykohet”. Në nenin 135 të Kushtetutës parashikohet se: “Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj”. Në lidhje me konceptin “*gjykatë e paanshme*”, e cila do të vendosë për mosmarrëveshjen, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë dhe përmbajtjen e dispozitave të Konventës së Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të Këshillit të Europës. Kjo Konventë është nënshkruar nga Republika e Shqipërisë në datë 13.7.1995, duke hyrë në fuqi në datën e ratifikimit të saj më 2.10.1996. Në zbatim të nenit 116 dhe 121 të Kushtetutës së Shqipërisë, dispozitat e kësaj Konvente janë pjesë e sistemit të brendshëm juridik të vendit.

Neni 6, paragrafi i parë, i kësaj Konvente parashikon të drejtën për një proces të rregullt. Ndër të tjera dispozita e këtij neni parashikon: “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga **një gjykatë e pavarur dhe e paanshme**, e krijuar ligjërisht, e cila do të vendosë qoftë për mosmarrëveshjet mbi të drejtat dhe detyrimet e tij me karakter civil, qoftë për bazueshmërinë e çdo akuze të natyrës penale të drejtuar kundër tij.”

Duke u mbështetur pikërisht në këtë dispozitë, paditësi ka pretenduar se, në gjykimin e çështjes së tij, Gjykata e Lartë nuk mund të konsiderohet si një gjykatë e paanshme, për shkak se është palë në proces.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se parimi i gjykimin të çështjes nga një gjykatë e paanshme gjen zbatim dhe në nenin 72/6 të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: “Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur: ... 6. në çdo rast tjetër kur vërtetohet, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie.”

Në vlerësimin e elementit të paanshmërisë së gjykatës që zgjidh mosmarrëveshjen, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë dhe qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Në çështjen **LANGBORGGER kundër SUEDISË**, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut arsyeton se: “Për të vlerësuar nëse një organ mund të konsiderohet “i pavarur”, duhet të shqyrtohet, inter alia, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tij dhe kohëzgjatja e mandatit, ekzistenca e garancive ndaj presioneve të jashtme dhe nëse organi paraqitet si i pavarur”. Përsa i takon parimit “gjykatë e paanshme”, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në po këtë çështje argumenton se: “në lidhje me çështjen e paanshmërisë, duhet të bëhet një dallim mes një testi subjektiv, që ka të bëjë me bindjen e një gjykatësi të caktuar mbi një çështje të caktuar dhe një testi objektiv, që shërben për t’u siguruar nëse një gjykatës ofron garancitë e mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të ligjshëm në këtë drejtim”.

Në rastin konkret paditësi ka kundërshtuar një urdhër të kryetarit të Gjykatës së Lartë për përfundimin e kontratës së tij të punës në këtë institucion. Kjo vendimmarrje e kryetarit të Gjykatës së Lartë nuk është rrjedhojë e ushtrimit të pushtetit gjyqësor, që parashikohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Ky urdhër i kryetarit të Gjykatës së Lartë është marrë në zbatim të nenit 7/ç të ligjit organik të kësaj gjykate. Sa më lart, Kryetari i Gjykatës së Lartë ka vepruar si organi që me ligj është ngarkuar të kujdeset për funksionimin normal të Gjykatës së Lartë, në rastin konkret të një pjese të administratës së saj të përbërë nga ndihmësit ligjorë, që punojnë secili pranë çdo gjyqtari të Gjykatës së Lartë nën autoritetin, mbikëqyrjen dhe besimin e tij.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nënvizojnë faktin se asnjë nga gjyqtarët e Gjykatës së Lartë që gjykojnë këtë çështje nuk ka qenë, dhe ligjërisht nuk mund të ishte, pjesë e procesit vendimmarrës që ka të bëjë me mbarimin e kontratës së punës me paditësin. Asnjëri nga anëtarët e Gjykatës së Lartë nuk ka qenë i detyruar dhe nuk rezulton që ndonjëherë të ketë shfaqur mendimin e tij, përsa i takon kësaj çështjeje, duke vënë kështu në dyshim paanësinë në gjykimin e kërtimeve të paditësit. Paditësi ka pasur lidhje të drejtpërdrejta pune vetëm me gjyqtarin Bashkim Caka, të cilit i ka mbaruar mandati. Njohjet personale që paditësi mund të ketë krijuar me gjyqtarët e tjerë nuk mund të

konsiderohen të tilla që të vënë në dyshim paanësinë e tyre në zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Në gjykimin e kësaj çështjeje, nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë është mbajtur parasysh dhe respektuar parimi “gjykatë e paanshme” dhe në një tjetër aspekt. Kështu, kryetari i Gjykatës së Lartë, urdhri i të cilit, bazuar në ligj, ka vendosur zgjidhjen e marrëdhënies së punës mes paditësit dhe Gjykatës së Lartë, nuk merr pjesë në trupën gjyqësore të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë që merr në shqyrtim këtë konflikt gjyqësor.

Duke iu referuar çështjes **HAUSCHILDT kundër DANIMARKËS**, vërehet se Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka vlerësuar si vijon: “*çdo gjykatës, për të cilin ekziston një arsye e ligjshme për të dyshuar mungesë të paanshmërisë, duhet të dalë nga trupi gjykues*”. Veç kryetarit të Gjykatës së Lartë, si punëdhënës i paditësit, i cili objektivisht është i përjashtuar nga gjykimi i kësaj çështjeje, për secilin nga të trembëdhjetë gjyqtarët e tjerë që përbëjnë trupën gjyqësore të shqyrtimit të kësaj çështjeje në Kolegjet e Bashkuara, nuk ekziston asnjë arsye e përligjur që të krijojë dyshime për mungesë të paanshmërisë. Në këndvështrimin subjektiv, ashtu siç parashtrohet edhe më lart, asnjë nga gjyqtarët nuk rezulton të ketë shfaqur paraprakisht mendimin për zgjidhjen e kësaj çështjeje, as të ketë interes të vetin për zgjidhjen e saj dhe as të ketë ndonjë lidhje personale apo arsye personale që të vinte në dyshim sado pak paanësinë e tij. Në këndvështrimin objektiv e gjithë trupa gjyqësore në tërësi, ashtu si dhe çdo gjyqtar i veçantë përbërës i saj, zotëron integritetin dhe garancitë e mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim për mungesë paanësie në gjykim.

Gjithashtu, paditësi nuk parashtroi ndonjë arsye konkrete mungesë paanësie për ndonjë gjyqtar të çështjes. Për më tepër, është e paarsyeshme, e papërligjur dhe e papranueshme të pretendosh në përgjithësi për mungesën e paanësisë së gjithë trupës gjyqësore, nisur vetëm nga fakti që ke qenë pjesëtar i administratës së gjykatës si institucion, por pa pasur lidhje pune të drejtpërdrejta dhe vartësie administrative me asnjërin gjyqtar që gjykon çështjen.

Në rastin konkret, edhe përsa i takon parimit “*gjykatë e pavarur*”, kryetari i Gjykatës së Lartë nuk ushtron asnjë pushtet a ndikim kushtetues/ligjor ndaj anëtarëve të Gjykatës së Lartë. Mënyra e emërimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë, kohëzgjatja e mandatit dhe shkaqet e përfundimit të tij, parashikohen nga nenet 136-140 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në funksionin e tij gjyqësor kryetari i Gjykatës së Lartë substancialisht nuk ushtron asnjë të drejtë më tepër se gjyqtarët e tjerë të kësaj gjykate. Kryesimi nga kryetari i trupit gjykues të kolegjit përkatës, kur ai merr pjesë në gjykim (neni 13/3 i ligjit nr.8588, datë 15.3.2000), drejtimi dhe kryesimi i kolegjeve të bashkuara (neni 7/a dhe neni 15/1 i ligjit në fjalë), janë të drejta me karakter procedural. Këto dhe disa të drejta të tjera me karakter administrativ dhe organizativ, të përcaktuara me ligj, nuk kanë asnjë ndikim në veprimtarinë dhe vendimmarrjen e gjyqtarëve të tjerë, si dhe në funksionin e kryetarit si gjyqtar, veçse formalisht i japin atij pozicionin e të parit ndërmjet të barabartëve (*primus inter pares*) në trupën gjyqësore, kur e kryeson atë.

Për kryetarin si gjyqtar, për të siguruar dhe garantuar paanësinë e tij në gjykim, për heqjen dorë nga gjykimi dhe për përjashtimin e tij me kërkesë të palëve, zbatohen të njëjtat kritere dhe rregulla si për të gjithë gjyqtarët e tjerë. Kryetari e çmoi vetë mospjesëmarrjen në gjykimin e kësaj çështjeje, ndërsa për gjyqtarët e tjerë nuk rezulton të ekzistojë ndonjë arsye për heqje dorë apo për të kërkuar përjashtimin e tyre nga gjykimi.

Si përfundim, **gjykimi i mosmarrëveshjes për largimin nga detyra të ndihmësit ligjor të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë prej një trupe gjyqësore të kësaj gjykate, në Kolegjin Civil apo në Kolegjet e Bashkuara, nuk cenon parimin e pavarësisë e të paanësisë në gjykim, të sanksionuar në nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave e Lirive Themelore të Njeriut, dhe nenin 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në respekt të këtyre parimeve, në shqyrtimin e çështjes nuk mund të marrë pjesë kryetari i Gjykatës së Lartë që ka të drejtën e vendimmarrjes për shkak të ushtrimit të detyrës si punëdhënës i ndihmësit ligjor, gjyqtari për të cilin ka punuar ndihmësi ligjor, si dhe çdo gjyqtar tjetër që për arsye të përligjura krijon dyshime për mungesë paanësie në gjykim.**

Veprimet procedurale për heqje dorë nga gjykimi i një çështjeje të caktuar apo për përjashtim nga pjesëmarrja në gjykimin e saj, për shkaqe të përligjura objektive apo subjektive, që vënë në dyshim mungesën e paanësisë në gjykim, nuk janë të drejta që ushtrohen në mënyrë kolektive për të gjithë trupën gjyqësore, por të drejta që ushtrohen në mënyrë individuale duke bërë vlerësimet përkatëse rast pas rasti.

Në këndvështrimin e ndërtimit institucional, në pajtim me dispozitat e Kushtetutës së

Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit organik të saj, në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë trupa gjyqësore, që ushtron vetëm funksione gjykimi, është ndarë qartësisht nga administrata dhe shërbimet e tjera ndihmëse. Kryetari i Gjykatës së Lartë, me cilësinë e drejtuesit të institucionit, ka kompetencën ekskluzive për të miratuar strukturën, organikën dhe rregullat e brendshme të Gjykatës së Lartë (neni 7/e i ligjit organik). Si punëdhënës, ai ka gjithashtu të drejtën ekskluzive për emërimin dhe shkarkimin e nëpunësve të administratës gjyqësore e të punonjësve të shërbimeve të tjera ndihmëse (neni 7/c,d). Ndërsa drejtimi, organizimi dhe mbikëqyrja e përditshme e veprimtarisë administrative kryhet prej kancelarit, si nëpunësi më i lartë administrativ i institucionit. Në harmoni me kompetencat e kryetarit të Gjykatës së Lartë si drejtues i institucionit dhe me funksionin e tij administrativ të punëdhënësit, janë miratuar edhe dispozitat për fitimin e një statusi të barabartë me atë të nëpunësve të shërbimit civil (të administratës publike) për nëpunësit e Gjykatës së Lartë si institucion kushtetues e i pavarur, veçanërisht përsa u përket pagave dhe shpërblimeve (neni 10 i ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil “dhe neni 9/1 i ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese ...”).

Neni 20 i ligjit organik të Gjykatës së Lartë ka rregulluar procedurën e emërimit, të mbarimit të kontratës, shkarkimit nga detyra, kriteret e përzgjedhjes, pagën, si dhe përfitime të tjera, të ndihmësit ligjor të gjyqtarit, në këtë mënyrë: “Neni 20/ Ndhmësit ligjorë.

Gjyqtari i Gjykatës së Lartë ka deri në dy ndihmës ligjorë dhe personin e shërbimit.

Ndhmësit ligjorë përzgjidhen nga vetë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë ndërmjet juristëve që plotësojnë kushtet ligjore për t'u emëruar gjyqtarë të gjykatës së shkallës së parë ose të gjykatës së apelit. Ata emërohen nga kryetari i Gjykatës së Lartë.

Ndhmësit ligjorë përfitojnë përkatësisht pagën e gjyqtarit të shkallës së parë ose të gjykatës së apelit. Ndhmësi ligjor largohet nga detyra me urdhër të kryetarit të Gjykatës së Lartë, me propozimin e gjyqtarit përkatës.

Kur largimi nga detyra është bërë pa arsye të përligjura, ai ka të drejtën vetëm të shpërblimit të dëmit deri në shumën e pagës vjetore.”

Ndërsa neni 21 përcakton detyrat e ndihmësit ligjor. Sipas kësaj dispozite, “Ndhmësit ligjorë studiojnë ankimet, dosjet gjyqësore, përgatisin relacionet për çështjet që janë në gjykim duke dhënë mendimin e tyre, u përgjigjen ankesave, përgatisin materialet e nevojshme, si dhe kryejnë çdo detyrë tjetër që u ngarkohet nga gjyqtari i Gjykatës së Lartë”.

Nga përmbajtja e dispozitave të mësipërme dhe nga interpretimi i tyre gramatikor, logjik e sistematik, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konfirmojnë praktikën e punës së deritanishme në zbatim të këtij ligji, përsa i përket problematikës në shqyrtim, duke nënvizuar përfundimet si më poshtë:

1. Veprimtaria e çdo gjyqtari të Gjykatës së Lartë funksionon e organizuar si një zyrë më vete nën drejtimin, kujdesin dhe kontrollin e tij, me një personel të përbërë prej deri në dy ndihmës ligjorë dhe personel tjetër shërbimi.

2. Përzgjedhja e ndihmësit ligjor ndërmjet kandidaturave që plotësojnë kriteret ligjore e morale të pranimin bëhet nga vetë gjyqtari përkatës, i cili i bën kryetarit propozimin për emërim.

3. Kryetari i Gjykatës së Lartë, si punëdhënës, formalizon emërimin, pa pasur diskrecion për mospranimin e kandidaturës.

Mospranimi i kandidaturës bëhet vetëm në rast se kandidati nuk plotëson kriteret.

4. Me daljen e aktit të emërimit ndihmësi ligjor lidh kontratë punësimiti në një shërbim publik, e cila ka afat deri në përfundim të mandatit të gjyqtarit për të cilin ai punon.

5. Kontrata mbaron rregullisht vetëm me mbarimin e mandatit të gjyqtarit. Ky konkluzion rezulton në mënyrë implicite nga interpretimi në tërësi i nenit 20 të ligjit.

6. Kontrata mund të zgjidhet para afatit nga gjyqtari përkatës dhe të formalizohet me urdhër të kryetarit të Gjykatës së Lartë.

7. Zgjidhja para afatit e kontratës së punësimit të ndihmësit ligjorë është në diskrecionin e gjyqtarit përkatës. Kryetari i Gjykatës së Lartë nuk ka të drejtë të urdhërojë gjyqtarin për ta mbajtur në punë ndihmësin ligjor jashtë vullnetit të tij, (gjyqtarit) edhe në qoftë se ai nuk parashtron shkaqe të përligjura e bindëse për largimin para afatit të ndihmësit ligjorë. Ky rregullim bëhet për arsye se marrëdhënia e punës gjyqtar-ndihmës ligjor bazohet në mirëbesimin. Humbja e besimit, për çfarëdo

lloj shkak apo motivi, passjell prishjen e kontratës.

8. Vetëm largimi nga detyra i ndihmësit ligjor para mbarimit të mandatit të gjyqtarit, pa arsye të përligjura, apo pa dhënë arsyt, i jep atij të drejtën e kërimit të dëmshpërblimit deri në shumën e pagës vjetore.

Si përfundim, **ndihmësi ligjor i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë e ushtron funksionin e tij bazuar në një kontratë punësimi me afat të një funksionari publik, e cila gjen rregullim të posaçëm në dispozitat e ligjit organik të Gjykatës së Lartë (nenet 20-21).**

Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit, duke mos përcaktuar drejt natyrën e marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja që paditësi ka kërkuar të zgjidhë gjyqësisht; duke mos përcaktuar drejt shkakun e padisë, d.m.th. të drejtën e tij subjektive dhe gjendjen e faktit të pretenduar, që i kundërvihet kësaj të drejte; duke mos bërë një cilësim të fakteve e veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen, pa qenë e lidhur me përcaktimin e propozuar nga paditësi; duke mos konstatuar bazën juridike të gabuar të padisë, kanë arritur në zgjidhjen e gabuar të çështjes.

Gjykatat i kanë bërë vlerësim të gabuar faktit juridik të përfundimit të kontratës së punësimit publik të paditësit, duke e konfunduar me rastin kur kjo kontratë zgjidhet në mënyrë të njëanshme (ndërpritet) nga punëdhënësi para kohe, gjatë vazhdimit të mandatit të gjyqtarit, sipas paragrafëve 4 e 5 të nenit 20.

Siç pretendohet me të drejtë në rekurs, rasti në shqyrtim nuk është i tillë. Ndhmësi ligjor Kaçurri nuk u largua para kohe nga detyra me propozim të gjyqtarit Caka. Ai iku bashkë me këtë të fundit pas mbarimit të mandatit të tij, ashtu siç kanë ikur edhe ndihmës të tjerë para tij me mbarimin e mandatit të gjyqtarëve përkatës.

Detyrimi për t'i mbajtur ende në punë këta ndihmës ligjorë, që me kalimin e viteve do të bëhen shumë, apo dëmshpërblimi i tyre eventual, nuk ka asnjë bazë ligjore. Mbarimi i kontratës është një fakt juridik i ligjshëm dhe jo veprim i fajshëm dhe i kundërligjshëm i punëdhënësit të tyre, siç ka pretenduar paditësi dhe kanë pranuar gjykatat.

Është i gabuar arsyetimi që bëjnë gjykatat në lidhje me vlerësimin e mbarimit të marrëdhënies së punës së paditësit, si zgjidhje e menjëherëshme e kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme. I gabuar është gjithashtu dhe argumentimi që ato i bëjnë një qëndrimi të tillë, duke iu referuar dispozitave përkatëse të Kodit të Punës në lidhje me trajtimin e këtyre elementeve. Kur ligji organik e ka bërë rregullimin përkatës të marrëdhënies së punës dhe ai ligj nuk të referon në dispozitat e Kodit të Punës, këto dispozita nuk mund të zbatohen në analogji.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë çmojnë se gjykatat duhet të kishin konkluduar se me mbarimin e mandatit kushtetues të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, do të konsiderohet *ipso jure* se ka mbaruar dhe kontrata e punësimit e ndihmësit të tij ligjor. Në këto raste, urdhri i kryetarit të Gjykatës së Lartë për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të ndihmësit ligjor, për shkak të mbarimit të kontratës së punësimit, në vetëvete vetëm konstaton mbarimin e kontratës së punës që ndihmësi ligjor ka me institucionin. Për këto arsye, gabimisht gjykatat kanë pranuar pretendimin e paditësit se nga ana e punëdhënësit duhej të ishte zbatuar procedura e zgjidhjes së kontratës së punës dhe afatet përkatëse të njoftimit.

Edhe sikur të ishte i zbatueshëm Kodi i Punës, nuk ishte rasti i zbatimit të këtyre kërkesave të nenit të Kodit të Punës, sepse ato zbatohen në rastet e zgjidhjes nga punëdhënësi të kontratës së punës me kohëzgjatje të pacaktuar (neni 141 i Kodit të Punës).

Ndërkohë parashikimi i paragrafit të fundit të nenit 20 të ligjit organik duhet të zbatohet vetëm në rastet kur përpara mbarimit të mandatit të gjyqtarit, ky i fundit kërkon nga kryetari i Gjykatës largimin nga detyra të ndihmësit. Në këtë rast, ndihmësit ligjor i lind e drejta për të kërkuar gjyqësisht hetimin e justifikueshmërisë së shkakut të largimit nga detyra, duke përfituar eventualisht dhe dëmshpërblimin e caktuar në ligj.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 485/d të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSËN:

Ndryshimin e vendimit nr.457, datë 7.4.2005 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe të vendimit nr.6005, datë 7.12.2004 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e padisë.

Ky vendim për unifikim të praktikës gjyqësore të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Kryesues: Kristaq Ngjela

Anëtarë: Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Artan Hoxha, Ardian Dvorani, Shpresa Beçaj, Gani Dizdari, Evjeni Sinoimeri, Agron Lamaj, Irma Bala.

MENDIMI I PAKICËS

Në vendimin unifikues nr.5, datë 22.1.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Nuk jemi dakord me vendimin e shumicës së gjyqtarëve të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për arsyet që do t'i parashtrojmë më poshtë:

Çështja civile me paditës ish-ndihmësin ligjor të Gjykatës së Lartë, Besnik Kaçurri dhe të paditur Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë, ka kaluar për gjykim në Kolegjet e Bashkuara, me arsyetimin se Kolegji Civil, "... pasi vlerësoi kërkesën paraprake të paraqitur nga përfaqësuesja e paditësit, gjykon se nuk mund ta shqyrtojë këtë çështje, për arsye se: Në respektim të një gjykimi të drejtë, siç parashikohet nga neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), për të siguruar paanshmërinë në gjykimin e kësaj çështjeje edhe në ballafaqim me praktikën e ... Plenumit të Gjykatës së Kasacionit (sot Gjykata e Lartë) ... Kolegjeve të Bashkuara u jepet mundësia të njësojnë ose të ndryshojnë praktikën gjyqësore në frymën e KEDNJ".

Nga aktet rezulton se përfaqësuesja e paditësit, në kërkesat paraprake (gjatë gjykimit në Kolegjin Civil), vuri në dukje se, në një çështje analoge, në të cilën Gjykata e Kasacionit (sot Gjykata e Lartë) e Shqipërisë ka qenë e paditur nga një ish-punonjës i saj (kryesekretari), në vendimin nr.3454, datë 30.9.1994 ka arsyetuar se: "Për të siguruar një gjykim të paanshëm, Gjykata e Kasacionit nuk mund të bëjë vlerësim të ri të rrethanave që ka pranuar gjykata e apelit dhe se ndodhemi përpara një rasti të veçantë, kur kjo gjykatë, për të mos cenuar paanësinë e saj, duhet t'i bindet vendimit të gjykatës së paanshme, asaj të apelit, pavarësisht se kjo është një hallkë më e ulët".

Rezulton gjithashtu se, në rekursin e paraqitur nga kryetari i Gjykatës së Lartë kundër vendimeve të dy shkallëve të gjykimit të kësaj çështjeje, shkaku i parë për të cilin, sipas tij (rekursit), kërkohej prishja e tyre, ishte pjesëmarrja në trupin gjykues të gjykatës së apelit që gjykoi çështjen, e gjyqtarit M. Saraçi, pasi, sipas rekursit, gjatë kohës që ky i fundit ishte gjyqtar në Gjykatën e Lartë, paditësi, për një periudhë kohe, ka qenë ndihmës ligjor i tij. Kjo shkelje e rëndë procedurale (sipas rekursit) lidhur me formimin e trupit gjykues, përbën shkak absolut për prishjen e vendimit.

Si shkak të dytë, rekursi parashtroi se gjykatat nuk kanë përcaktuar drejt marrëdhënien juridike midis palëve, mbi bazën e së cilës ka lindur konflikti, duke konsideruar referimin në Kodin e Punës si arbitrar dhe, për më tepër, duke u nisur pikërisht nga kjo, vendimet e dy gjykatave i konsideron haptazi të kundërligjshme.

Mirëpo shumica, meqenëse konstatoi se nuk ishte e vërtetë që paditësi të kishte qenë ndihmës ligjor i gjyqtarit M.Saraçi, në arsyetimin e vendimit të saj, u përqendrua kryesisht në argumentimin e kuptimit të parimit të paanësisë së gjyqtarit (duke pasur parasysh gjyqtarin e Gjykatës së Lartë në raport me kryetarin e kësaj gjykate) dhe në mosinterpretimin e saktë të kuptimit të dispozitës së nenit 20 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë".

Për arsye metodike, si dhe për shkak të zgjidhjes që i u dha çështjes (duke rrëzuar padinë), pakica do ta fillojë arsyetimin e saj kundër nga shkaku i dytë që përmban rekursi.

Shumica arriti në përfundimin unifikues, sipas të cilit ndihmësi ligjor i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë e ushtron funksionin e tij bazuar në një kontratë punësimi me afat të një funksionari publik, e cila gjen rregullim të posaçëm në dispozitat e ligjit organik të Gjykatës së Lartë (nenet 20-21), përfundim me të cilin është plotësisht dakord edhe pakica. Mirëpo argumentet që përdor shumica për të arritur në këtë përfundim, sipas mendimit të pakicës, jo vetëm që janë rrjedhojë e interpretimit të gabuar të kuptimit të përmbajtjes së dispozitave të neneve 20 dhe 21 të ligjit të përmendur, por vijnë ndesh edhe me praktikën e ndjekur, në disa raste të tjera, kur ndihmës ligjorë të veçantë, **me të drejtë,**

nuk janë larguar nga puna, deri në zëvendësimin e gjyqtarit, duke ia lënë, në këtë mënyrë (përsëri me të drejtë), praktikisht të drejtën atij për t'i mbajtur apo larguar ata nga puna. Pakica e konsideron të drejtë këtë lloj praktike, pasi, veç interesit personal që mund të ketë dhe ka për vetë ndihmësin ligjor që mbahet në detyrë dhe mbas mbarimit të mandatit të gjyqtarit, ndihmës i të cilit ai ka qenë, ajo i shërben edhe vijimësisë së krijimit të një përvoje (për atë që mund t'u takojë ndihmësve ligjorë në këtë proces) në lidhje me sistemimin e praktikës së Kolegjeve të Gjykatës së Lartë dhe sidomos të plotësisë dhe cilësisë së relacioneve që përgatiten prej tyre për çështjet që u ngarkohen.

Përsa i përket interpretimit të dispozitës së nenit 20 të ligjit organik, megjithëse shumica, ashtu sikurse edhe rekursi e citon, në mënyrë të përsëritur atë, elementit thelbësor që ka lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e gjykimit të çështjes konkrete, i jep kuptim, sipas pakicës, të gabuar. Ky element gjendet i shprehur në paragrafin e parafundit të dispozitës së përmendur, në pjesën e fundit të të cilit, në formë krejtësisht të qartë, përcaktohen modalitetet e procedurës që duhet të ndiqet për largimin e ndihmësit ligjor nga detyra. Kështu, është e vërtetë që ai largohet nga detyra me urdhrë të kryetarit të Gjykatës së Lartë (i cili, veç të tjerave, vepron edhe si përfaqësues i këtij personi juridik publik si në marrëdhëniet me të tretët, ashtu edhe me punonjësit e vetë Gjykatës së Lartë, jo gjyqtarë), por ky i fundit mund të nxjerrë urdhrin e largimit, **jo me iniciativën e tij, por vetëm pasi t'i jetë bërë propozimi nga gjyqtari përkatës**, për një gjë të tillë. Ky kusht në rastin e paditësit nuk është përmbushur, pasi një propozim i tillë nuk ka ekzistuar. Arsyetimi i shumicës, sipas të cilit me përfundimin e mandatit të gjyqtarit që e kishte përzgjedhur si ndihmës, përfundojnë, automatikisht edhe marrëdhëniet e posaçme të punës së ndihmësit ligjor pranë tij me institucionin e Gjykatës së Lartë, për mendimin e pakicës, nuk përputhet me kërkesën procedurale të përmendur pak më lart. Edhe në aspektin e funksionimit normal të institucionit, në kushtet kur dihet se vendi bosh i gjyqtarit të larguar do të zëvendësohej dhe fondi i pagës për ndihmësin ligjor që përkohësisht mbetet pa gjyqtar, ishte i miratuar tashmë, do të ishte logjike që t'i lihej gjyqtarit që do të mandatohej rishtaz e drejta për të vendosur, nëse do ta mbante apo për të bërë propozimin për largimin e tij nga detyra.

Kështu që, për arsyet që u renditën shkurtimisht më lart, argumenti i përdorur nga shumica, sipas të cilit paditësi iku bashkë me gjyqtarin Caka, pas mbarimit të mandatit të këtij të fundit, ashtu siç kanë ikur edhe ndihmës të tjerë para tij me mbarimin e mandatit të gjyqtarëve përkatës, nuk gjen mbështetje në ligj dhe nuk i përgjigjet të vërtetës, lidhur me praktikën që është ndjekur në raste të ngjashme (sado të pakta qofshin ato) me ndihmës ligjorë të tjerë pas mbarimit të mandatit të gjyqtarëve që i kishin përzgjedhur.

Për më tepër, i pabazuar është ky argument po të kihet parasysh përmbajtja e shkresës nr.T-251 Prot., datë 2.12.2004 e kancelarit të Gjykatës së Lartë, sipas së cilës paditësi ka qenë në marrëdhënie pune në Gjykatën e Lartë më shumë se katër vjet (që nga 1.9.1996) para daljes së ligjit organik të këtij institucioni (15.3.2000) dhe, fakti që, mbas daljes së ligjit, ai është emëruar (dhe jo përzgjedhur) ndihmës ligjor pranë gjyqtarit B.Caka, fakt ky që tregon për vijimësi të marrëdhënies së punësimit të tij me Gjykatën e Lartë. Pikërisht kushtet specifike që kanë paraprirë dhe mbi të cilat vazhdoi (pavarësisht ligjit organik) marrëdhëniet e punësimit të paditësit me Gjykatën e Lartë, ndryshe nga përfundimi i shumicës sipas të cilit, me daljen e aktit të emërimit ndihmësi ligjor lidh kontratë punësimi në një shërbim publik, i japin kësaj marrëdhënieje karakteristika të veçanta, të cilat duhej të ishin marrë parasysh nga shumica si argumente plus në favor të kërkesës, në çështjen objekt gjykimi.

Sikundër u përmend, shkak i tjetër që parashtrohet në rekurs, ka të bëjë me aspektin e rëndësishëm të paanësisë së gjykatës, i cili shërbeu edhe si shkak i vetëm për kalimin e çështjes në Kolegjet e Bashkuara, duke shtruar para tyre mundësinë e njësimi apo ndryshimit të praktikës gjyqësore në frymën e KEDNJ.

Lidhur me këtë, pakica është e mendimit që, edhe në zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi duhej të ishte ndjekur praktika e plenumit të ish-Gjykatës së Lartë, i cili, për të mos cenuar paanësinë e tij si gjykatë (në kushtet kur shqyrtohej një mosmarrëveshje e lindur midis titullarit të vetë Gjykatës së Lartë dhe një punonjësi të saj), çështjen e konsideroi rast të veçantë dhe për të mos cenuar parimin e paanësisë, iu bind vendimit të gjykatës së apelit, pavarësisht se ajo ishte hallkë më e ulët se vetë e para.

Zgjidhja që i dha plenumi i ish-Gjykatës së Lartë çështjes konkrete, për pakicën, vendosi standard të përparuar në raport me kohën, ndërsa, në kushtet aktuale kur çështja është duke u gjykuar, mbasi Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) është bërë pjesë e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, standardi i vendosur tashmë lidhur me paanësinë e gjykatave

bëhet dhe më i detyrueshëm për gjykatat shqiptare, përfshirë edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Anëtarë: Perikli Zaharia, Ylvi Myrtja, Spiro Spiro.